

 KEC Qendra për Arsim e Kosovës Kosova Education Center	SYLLABUSI I PROGRAMIT TË TRAJNIMIT		F-042
	Prishtinë	v. 2.0	Faqe 1 nga 5

Kodi 082

RINIA NË PUNË

Tipi i Programit: Plotësues

Hyrje

Në Kosovë, mosha minimale për punësim është mosha 15 vjeçare dhe kjo grupmoshë ka më shumë gjasë të jenë pa përvojë dhe pa informacion për shumë detyra që priten prej tyre. Siguria në punë është zakonisht gjëja e fundit për të cilën ata brengosen. Shumë nga tiparet më pozitive të të rinjve-energji, entuziazmi dhe nevoja për përgjegjësi dhe sfida gjithnjë e më të mëdha, mund të ndikojnë që ata të marrin përsipër obligime për të cilat nuk do të jenë të përgatitur që t'i përmbushin në mënyrë të sigurt. Ata gjithashtu kanë tendencë të hezitojnë të shtrojnë pyetje dhe t'u bëjnë kërkesa punëdhënësve të tyre. Shumë prej tyre përfundojnë duke punuar në kushte të rrezikshme.

Për t'i adresuar këto probleme, vendet e zhvilluara ka vite që kanë filluar me integrimin e koncepteve të sigurisë dhe shëndetit në punë në kuadër të kurrikulave shkollore. Në nivelin fillor, këto kurrikula fokusohen në arsimimin për mbrojtje nga rreziqet, p.sh. përgatitja e fëmijëve që jo vetëm të identifikojnë rreziqet e ndryshme në mjediset ku e kalojnë kohën por edhe të ndërmarrin hapa të nevojshëm për t'u shmangur atyre. Në nivelin e mesëm të ulët dhe të lartë, kurrikulat janë kryesisht të përqëndruara në përgatitjen e fëmijëve për botën e punës pasi që ata i afrohen moshës minimale të punësimit. Vetdijësimi i fëmijëve për sigurinë dhe shëndetin në punë nuk ka të bëjë vetëm me përgatitjen e tyre për siguri vetanake në vendin e punës, por konsiderohet edhe si një element i rëndësishëm për ndërtimin e një kulture të parandalimit dhe për avansimin e sigurisë në vendet e punës.

Duke njohur rëndësinë e përfshirjes së arsimit për shëndetin dhe sigurinë në punë në kuadër të përvojave mësimore të nxënësve që në nivelin e mesëm të ulët, Ministria e Arsimit Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit ka kërkuar mbështetjen e Zyrës Ndërkombëtare të Punës, Programi për Eliminimin e Punës së Fëmijëve (ILO IPEC) për hartimin e një moduli mbi sigurinë dhe shëndetin në punë.

Si përgjigje në këtë kërkesë, ILO IPEC i ka rekomanduar MASHTI-t përshtatjen e kurrikulës "Rinia në punë: Diskutim për sigurinë" (*Youth @ Work Talking Safety Curriculum*) hartuar nga Instituti Kombëtar i Shteteve të Bashkuara të Amerikës për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë (*US National Institute for Occupational Safety and Health - NIOSH*).

Kjo kurrikulë ndihmon zotërimin e dijeve themelore mbi sigurinë në punë dhe është relevante për çdo profesion dhe për çdo fazë të jetës së punës. Aktivitetet e të nxënësve në këtë kurrikulë synojnë ngritjen e vetëdijes së të rinjve mbi sigurinë në vendin e punës dhe zhvillimin e shkathtësive të nevojshme që të bëhen pjesëmarrës aktiv në ndërtimin e mjediseve të sigurta dhe të shëndetshme të punës, tani dhe gjatë gjithë jetës së tyre.

Arsimi për sigurinë dhe shëndetin në punë është qenësor për t'i parandaluar lëndimet e të rinjve në punë. Në këtë kontekst, është shumë e rëndësishme që ata krahas trajnimeve të veçanta të sigurisë në punë (që u referohen sektorëve të caktuar punues, respektivisht profesioneve të veçanta) t'i zotërojnë edhe shkathtësitë e përgjithshme dhe të transferueshme të shëndetit dhe sigurisë në punë. Të rinjtë duhet të përgatiten që t'i identifikojnë rreziqet në çdo vend pune. Ata duhet të kuptojnë se rreziqet

mund të kontrollohen, duhet të jenë të përgatitur të veprojnë në situata emergjente, duhet të jenë të informuar për të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre në punë dhe duhet të jenë në gjendje të flasin në mënyrë efektive kur të përballen me probleme në punë. Kurrikulat shkollore duhet të ofrojnë një vend të rëndësishëm për mësimin e këtyre aftësive.

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit po i kushton një vëmendje të veçantë kësaj çështjeje. Ndryshimet kurrikulare që kanë ndodhur viteve të fundit, të formësuara në dokumentet bazike si Korniza e Kurrikulës dhe Kurrikulat Bërthamë, ofrojnë hapësirë të mjaftueshme për trajtimin e kësaj çështjeje me rëndësi. Këto dokumente në thelbin e tyre përmbajnë zhvillimin e kompetencave për arsimin gjatë tërë jetës, të lidhura ngushtë me kërkesat e tregut të punës. Filozofia e kurrikulës së re përqendrohet në krijimin e këtyre aftësive tek të rinjtë. Synohet që ato të arrihen përmes të gjitha fushave kurrikulare. Por, fusha kurrikulare “Jeta dhe puna” e veçanërisht konceptet mësimore të lidhura me Teknologjinë janë të dedikuara për t’i realizuar ato drejtpërdrejt. Ndërsa, përmes fushave të tjera kurrikulare mund të ofrohet si p.sh. përmes moduleve mësimore të praktikës profesionale (si njësi e veçantë modulare) në shkollat e mesme profesionale dhe përmes fushës kurrikulare “Shoqëria dhe mjedisi”, në gjimnaze. Gjithashtu, ky modul mund të realizohet edhe tek pjesa e mësimin me zgjedhje, varësisht nga interesimet, kërkesat dhe nevojat e nxënësve.

Qëllimi i programit dhe rezultatet e pritura

Moduli ‘Siguria në punë’ është përgatitur për shfrytëzim në nivelin e mesëm të ulët, shkalla kurrikulare 4, në kuadër të fushës mësimore ‘Jeta dhe puna’, respektivisht te lënda apo konceptet e teknologjisë, te klasa e IX. Gjithashtu, te niveli i mesëm i lartë, shkalla kurrikulare 5 – te gjimnazet do të mësohet në kuadër të fushës kurrikulare ‘Shoqëria dhe mjedisi’, ndërsa te shkollat profesionale në po të njejtën shkallë kurrikulare, do të shfrytëzohet në kuadër të moduleve mësimore të praktikës profesionale (si modul i veçantë).

Qëllimi i programit është aftësimi i kuadrit mësimor për pajisjen e mësimdhënësve dhe të nënësve që e arrijnë moshën e punësimit, me njohuritë lidhur me rreziqet që mund të përballen në punë. Ky është program për trajnimin e trajnerëve, dhe ka për qëllim aftësimin dhe mbështetjen e trajnerëve potencialë për zbatimin e modulit ‘Siguria në punë’. Programi mundëson zhvillimin e aftësive dhe përvetësimin e njohurive themelore mbi sigurinë dhe shëndetin në punë, relevante për çdo profesion dhe për çdo fazë të jetës së punës. Aftësitë e transferueshme që zhvillohen përmes këtij moduli do të ndihmojnë nxënësit të jenë të sigurt dhe të shëndetshëm gjatë gjithë jetës së tyre. Ato kontribuojnë drejtpërdrejt dhe në zotërimin e kompetencave kryesore të Kurrikulës së Arsimit Parauniversitar në Kosovë.

Në përfundim të trajnimit pritet nga pjesëmarrësit që të:

- Kuptojnë se të gjithë punëtorët mund të lëndohen, sëmuren ose të humbin jetën në punë;
- Kuptojnë se lëndimet dhe sëmundjet që lidhen me punën janë të parashikueshme dhe mund të parandalohen;
- Identifikojnë rreziqet në punë dhe parashikojnë efektin e tyre të mundshëm në një vend pune;
- Përshkruajnë mënyrat më të mira për të adresuar rreziqet në vendin e punës;
- Identifikojnë urgjencat në punë dhe zgjedhin mënyrat më të mira për t’i adresuar ato;

	SYLLABUSI I PROGRAMIT TË TRAJNIMIT		F-042
	Prishtinë	v. 2.0	Faqe 3 nga 5

- Jenë të vetëdijshëm për të drejtat dhe përgjegjësitë e punëdhënësve dhe punëtorëve sa i përket sigurisë dhe shëndetit në punë;
- Gjejnë burime të informacioneve për sigurinë dhe shëndetin në punë;
- Demonstrjnë forma të komunikimit efektiv me të tjerët për zgjidhjen e problemeve të sigurisë dhe shëndetit në punë – përfshirë komunikimin me njerëzit me autoritet dhe punëdhënësit e tyre.

Përmbajtja

Kurrikuli RINIA NË PUNË – Diskutim mbi sigurinë, përfshinë planet e detajuara për gjashtë njësi mësimore themelore dhe katër njësi plotësuese. Temat kryesore që duhet të mbulohen në njësitë mësimore përfshijnë:

1. Lëndimet e punëtorit të ri
2. Identifikimi i rreziqeve
3. Përmirësimi i sigurisë në punë
4. Emergjencat në punë
5. Të drejtat dhe përgjegjësitë e punëtorëve
6. Ndërmarrja e veprimit

Grupi i synuar

Grupi i synuar i programit të trajnimit janë kryesisht mësimdhënësit e fushës 'Jeta dhe puna' dhe 'Shoqëria dhe mjedisi', por nuk përjashtohen as mësimdhënësit e fushave tjera mësimore të cilët janë të angazhuar në shkallët 4 dhe 5 të kurrikulës.

Fillimisht programi do të pilotohet me një grup prej 20-25 pjesëmarrës¹, pastaj do të dërgohet për aprovim nga KShLM. Kandidatët e suksesshëm të grupit të parë do të certifikohen në momentin e aprovimit të programit. Ky grup do të shfrytëzohet për trajnimin e mësimdhënësve të tjerë në shkolla, numri i të cilëve varet nga MASHTI, dhe donatorët potencial.

Forma e organizimit dhe kohëzgjatja

Programi i trajnimit është treditor i përbërë nga gjithsej 12 sesione. Secili sesion zgjatë 90 minuta dhe fokusohet në gjashtë temat kryesore të modulit 'Siguria në punë', duke shfrytëzuar materialet e këtij programi (power point, fletat e punës, etj.). Do të ketë sesione plenare dhe punë në grupe, varësisht nga aktivitetet. Plus kësaj, në mes të ditës së dytë dhe tretë janë 3-4 javë që pjesëmarrësit të realizojnë njësitë mësimore me nxënës në shkollë. Pasi kanë përzgjedhur njësitë mësimore nga moduli 'Siguria në punë' (këtë do ta vendosin në sesionin e fundit të ditës së dytë të trajnimit), kandidatët do

¹ Kandidatët e këtij programi të trajnimit për trajnerë do të përzgjedhen në bazë të kriterëve vijuese:

- Të jenë mësimdhënësit entuziast dhe me performancë të lartë të shkollave të mesme të ulta dhe të larta;
- Të kenë trajnime të përfunduara nga fusha të ndryshme kurrikulare, dhe më gjerë;

Përparësi kanë kandidatët që kanë të përfunduar kursin e standardeve të fasilitimit, respektivisht të shkathtësive për trajnim.

	SYLLABUSI I PROGRAMIT TË TRAJNIMIT		F-042
	Prishtinë	v. 2.0	Faqe 4 nga 5

të realizojnë me nxënës në shkollë së paku tri nga dhjetë njësitë mësimore nga programi 'Rinia në punë', varësisht nga lënda që e mbajnë apo preferenca e tyre për aktivitete jashtë-kurrikulare. Kuptohet se është e preferueshme që ata t'i zbatojnë të gjitha mësimet e programit me nxënës, nëse për këtë e gjejnë hapësirën kohore në programin shkollor. Nëse kanë interesim, ata mund të realizojnë edhe aktivitete ekipore, ku mund të integrohen çështje nga fusha të ndryshme mësimore të ndërlidhura me punën e fëmijëve. Gjatë tërë kësaj periudhe pjesëmarrësit do të mbledhin evidenca siç janë, planet dhe analizat për aktivitetet e realizuara me nxënës, fleta pune, foto të aktiviteteve, etj., për të kompletuar dosjen e tyre si mësimdhënës.

Materialet e punës janë fleksibile dhe mësimdhënësit mund t'i përshtasin ato për nivelin, respektivisht shkallën kurrikulare kur zhvillohet moduli, si dhe për fushën kurrikulare në kuadër të së cilës zhvillohet moduli. Mësimdhënësit poashtu mund të zgjedhin shembuj dhe skenarë të tjerë të vendeve të punës që mund të jenë tipik për komunitetin ku vepron shkolla dhe për nevojat e nxënësve me të cilët zhvillohet ky modul.

Gjatë periudhës së realizimit të aktiviteteve, kandidatët do të mbështeten dhe mentorohen nga trajnerët e kursit. Evidencat / portfoliot për realizimin e aktiviteteve do të dorëzohen një javë para ditës së tretë, për vlerësim dhe plotësime eventuale. Pastaj ato prezantohen në ditën e tretë të trajnimit, dhe diskutohen me pjesëmarrësit e tjerë.

Vlerësimi / Certifikimi

Për t'u certifikuar si trajnerë për programin 'Rinia në punë', në fund të punëtorisë treditore do të realizohet vlerësimi i kandidatëve. Trajnerët do të certifikohen duke u kredituar me gjithsej 32 orë pedagogjike, varësisht se si bëhet kalkulimi, me orë të plotë 60 minutëshe, apo me orë pedagogjike 45 minutëshe.

Kalkulimi i pikëve për licencim:

32 orë = 8 orë pedagogjike x 3 ditë trajnimi + 4 orë pedagogjike për zbatim të njësive në shkollë + 4 orë pedagogjike për reflektim dhe diskutim të dokumenteve /çështjeve.

Kriteret për certifikim janë:

- 90% pjesëmarrje aktive në trajnim dhe në takimet reflektuese me mentor;
- Realizimi i së paku tri njësive mësimore nga moduli 'Siguria në punë', dhe mbledhja e evidencës me nxënës gjatë punës me nxënës (krijimi i portfolios);
- Demonstrimi i shkathtësive moderuese, në ditën e tretë të trajnimit, gjatë prezantimit të portfolios së realizuar me nxënësit;
- Pjesëmarrje aktive me diskutime në sesionet finale gjatë prezantimit të pjesëmarrësve.

Vlerësimi dhe komentet për portfolio bëhen nga trajnerët e programit para ditës së tretë. Ndërsa në ditën e tretë ata prezantojnë për pjesëmarrësit e tjerë, marrin sugjerimet prej tyre dhe bëhet një

	SYLLABUSI I PROGRAMIT TË TRAJNIMIT		F-042
	Prishtinë	v. 2.0	Faqe 5 nga 5

diskutim i hapur për mundësitë tjera të realizimit të aktiviteteve në shkollë. Për vlerësim final të kandidatëve merret parasysh edhe aktiviteti i tyre gjatë këtyre diskutimeve, përfshirë shkathtësitë e prezantimit dhe moderimit.

Materialet e trajnimit:

Dokumenti kryesor burimor për trajnimin është Kurrikuli RINIA NË PUNË - Diskutim mbi sigurinë. Materiali përfshinë planet mësimore për njësi themelore dhe njësi plotësuese. Secila njësi përmban udhëzime të qarta për realizim, siç vijon:

- Qëllimi i orës mësimore
- Çështjet kryesore
- Përgatitja
- Plani i orës mësimore
- Udhëzime për realizim të njësisë mësimore
- Materiale për mësimdhënës
- Materiale për nxënës

Gjatë trajnimit të trajnerëve (fasilituesve) do të shfrytëzohen:

- Kurrikuli RINIA NË PUNË – Diskutim mbi sigurinë;
- Udhëzuesi për fasilitues të programit trajnues së bashku me fletat e punës;
- Sllajdet RINIA NË PUNË – Hyrja;
- Sllajdat RINIA NË PUNË – Mësimet 1-6;

Dokumentet tjera burimore përfshijnë:

- Udhëzimin Administrativ QRK Nr. 05/2013 për Parandalimin dhe Ndalimin e Formave të Rrezikshme të Punës së Fëmijëve në Kosovë;
- Procedurat Standarde të Veprimit për fëmijët e përfshirë në format e rrezikshme të punës.